	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të suportoje 'Jumbo Frame';</li> <li>• Të suportoje LLDP;</li> <li>• FHRP/VRRP;</li> <li>• Të suportoje rutime: <ul style="list-style-type: none"> <li>○ asimetrike,</li> <li>○ BGP,</li> <li>○ OSPF,</li> <li>○ RIP/RIPv2;</li> <li>○ Të bazuara në politika;</li> </ul> </li> <li>• Të suportoje QoS, QoS;</li> <li>• Të suportoje Multicast: <ul style="list-style-type: none"> <li>○ IGMP Snooping;</li> <li>○ Suport të përgjithshëm;</li> <li>○ PIM Snooping;</li> <li>○ IGMP Leave/Fast-Leave;</li> </ul> </li> </ul>
<b>Power</b>	Të jetë i pajisur me një bllok ushqimi 100–240V AC, 50/60 Hz
<b>Certifikimi</b>	ICSA Labs: Firewall, IPsec, IPS, Antivirus, SSL-VPN
<b>Karakteristikat mjedisore</b>	Temperatura e operimit: 0 – 40 gradë Celsius
<b>Garancia</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 1 vit suport nga prodhuesi në nivelin 24 orë / 7 ditë;</li> <li>• Suport nëpërmjet WEB;</li> <li>• Suport i diferencuar në varësi të kriticitetit të problemit;</li> <li>• Përditësimet e softuerit të jenë të përfshira;</li> </ul>

## Pajisje menaxhimi

Pajisja e menaxhimit duhet të ofrohet në formën e makinës virtuale dhe duhet të sigurojë menaxhim të centralizuar, të orientuar nga automatizimi i të gjitha pajisjeve NGFW nga një konsollë e vetme.

Pajisja e menaxhimit duhet të ketë veçoritë e mëposhtme:

- Të menaxhojë në mënyrë qendrore politikat e rrjetit dhe të sigurisë për minimumi 100 pajisje NGFW
- Të menaxhojë Secure SD-WAN;
- Të mundësojë përditësime të nënshkrimeve (signatures) për pajisjet NGFW;
- Të mundësojë shpërndarje të centralizuar të përmbajtjes së sigurisë dhe nënshkrimeve nëpërmjet përdorimit të një moduli të integruar;
- Të mundësojë konfigurim, vendosje dhe mirëmbajtje në mënyrë sa më të thjeshtë për SD-WAN;
- Të minimizojë kompleksitetin dhe kostot duke përdorur REST API të automatizuar, skripte, ndërlihdës dhe automatizime të tjera të ndryshme;
- Të automatizojë proceset e punës dhe konfigurimet për firewall-et NG;
- Të diferencojë të dhënat dhe të menaxhojë domenet duke shfrytëzuar domenet administrative, për të qenë të pajtueshme me politikat e sigurisë dhe efektive në funksionalitete;
- Të ofrojë disponueshmëri të lartë për të automatizuar kopjet rezervë për deri në pesë nje/nivele me softuer sa më të thjeshtë, si dhe të mundësojë përditësime sigurie për të gjitha pajisjet e menaxhuara;
- Pajisja e menaxhimit duhet të pajiset me licencë 1-vjeçare;



- 
- Të mundësohet suport i nivelit 24 orë / 7 ditë, nëpërmjet ueb, duke ofruar përditësime të firmuerit, si dhe suport nëpërmjet telefonit;

### **Pajisje për menaxhimin e ngjarjeve/log-eve**

Pajisja e regjistrimit të ngjarjeve/log-eve duhet të ofrojë një platformë të fuqishme të menaxhimit, analizës dhe raportimit të ngjarjeve, për të mundësuar menaxhim, automatizim dhe orkestrim nga një konsolë e vetme, duke mundësuar operacione sa më të thjeshtuara sigurie, identifikim proaktiv, korrigjimin e rrezeve, si dhe vizibilitet të plotë të të gjithë pamjes së sulmit.

Pajisja e logimit duhet të ofrohet në formën e makinës virtuale dhe të ketë veçoritë e mëposhtme:

- Të mundësojë analizë të integruar me korrelacion ngjarjesh dhe zbulim në kohë reale në të gjitha regjistrat, me shërbimin e 'Indicators of Compromise' (IOC) dhe zbulimin e kërcënimeve të avancuara;
- Të ofrojë integrim me NGFWs, EPP, Sandbox, Web Application Firewall, Email Security Gateways, etj., për vizibilitet më të plotë dhe njohuri kritike të rrjetit;
- Të mundësojë disponueshmëri të lartë të për të rezervuar automatikisht bazat e të dhënave të pajisjes së regjistrimit deri në grupime (cluster) prej katër nyjesh, të cilat mund të shpërndahen gjeografikisht për rikuperimin e informacionit nga problematika dhe/ose fatkeqësi;
- Të ofrojë automatizim të sigurisë për të reduktuar kompleksitetin, duke përdorur REST API, skriptet, ndërlihdës dhe automatizime të ndryshme, për të përshpejtuar reagimin dhe për të reduktuar kohën e zbulimit të problemeve të sigurisë;
- Të mundësojë zgjidhje të tipit 'multi-tenant' për menaxhimin e kuotave, duke shfrytëzuar domenet administrative për të diferencuar të dhënat dhe për të menaxhuar domenet për efektivitet operacional dhe përputhshmëri me politikat e vendosura;
- Të ofrojë opsione fleksibël për instalimin në VM, në site ose cloud publike;
- Të ketë kapacitet për të regjistruar minimumi 50 GB informacion (log-e, ngjarje) në ditë
- Pajisja e menaxhimit duhet të pajiset me licencë 1-vjeçare;
- Të mundësohet suport i nivelit 24 orë / 7 ditë, nëpërmjet ueb, duke ofruar përditësime të firmuerit, si dhe suport nëpërmjet telefonit;

### **Specifikimet Teknike SIEM**

#### **Zgjidhje SIEM – 1 copë**

1. Zgjidhja SIEM duhet të sigurojë një arkitekturë të shkallëzuar me karakteristikat e mëposhtme:
  - a. Të gjithë komponentët e Mbledhësit (Collector) të ngjarjeve, të mund të ofrohen si një pajisje virtuale ose pajisje fizike.
  - b. Mbledhësit duhet të përcjellin të dhënat e ngjarjeve në hapësirën e ruajtjes dhe korrelimit.
  - c. Mbledhësit duhet të jenë në gjendje të ruajnë informacionin e të dhënave nëse hapësira e ruajtjes dhe korrelimit bëhet e padisponueshme. Mbledhësi duhet të mbajë regjistrat e cache-imit deri në kapacitetin e tij të ruajtjes.
  - d. Mbledhësit duhet të jenë në gjendje të kufizojnë kapacitetin e rrjetit (bandwidth) të përdorur për marrjen dhe ruajtjen e ngjarjeve.

- 
- e. Mbledhësit duhet të kompresojnë të dhënat përpara se t'i dërgojnë në hapësirën e ruajtjes dhe korrelimit.
  - f. Mbledhësit duhet të komunikojnë me hapësirën e ruajtjes dhe korrelimit përmes protokollit HTTPS. Drejtimi i komunikimit duhet të jetë nga mbledhësit në hapësirën e ruajtjes dhe korrelimit.
  - g. Nëse një mbledhës dështon, një mbledhës zëvendësues mund të vendoset thjesht duke regjistruar një pajisje të re me hapësirën e ruajtjes dhe korrelimit. Mbledhësit nuk duhet të konfigurohen individualisht, por të menaxhohen në mënyrë qendrore. Ata nuk duhet të ketë konfigurim specifik, përveç informacionit të adresës IP që duhet të rishpërndahet.
  - h. Mbledhësit duhet të jenë në gjendje të përpunojnë > 10K EPS (events per second – ngjarje në sekondë).
  - i. Mbledhësit duhet të kryejnë procesin e zbulimit dhe të mbledhin të dhëna të performancës duke përdorur protokolle të ndryshme si SNMP, WMI, SSH, etj.
  - j. Mbledhësit duhet të jenë në gjendje të përpunojnë informacione NetFlow.
  - k. Mbledhësit duhet gjithashtu të përditësojnë automatikisht analizuesit e rinj kur ata përditësohen në sistemin qendror të menaxhimit të SIEM.
  - l. Kur vendoset në një mjedis multi-tenant, një mbledhës duhet të jetë në gjendje të trajtojë log-et e grumbulluara nga shumë marrës (tenants) në të njëjtën kohë.
  - m. Përmirësimet e firmuerit të mbledhësve duhet të trajtohen nga konsola ueb e SIEM, duke shmangur nevojën për t'u lidhur me secilin mbledhës për të kryer përmirësimin individualisht.
  - n. Mbledhësit duhet të mbështesin komunikimin indirekt me pjesën tjetër të komponentëve të SIEM nëpërmjet HTTP Proxy.

2. Niveli i ruajtjes dhe korrelimit SIEM i quajtur edhe si SIEM Cluster duhet:

- a. Të përdorë pajisjet virtuale si dhe ato fizike
- b. Pajisja virtuale duhet të mundësohet për:
  - i. VMware,
  - ii. Hyper-V
  - iii. KVM
  - iv. AWS
  - v. Azure
- c. Cluster i SIEM mund të shkallëzohet duke shtuar pajisje virtuale shtesë në grup. Kjo aftësi shkallëzimi duhet:
  - i. Të sigurojë korrelim rregullash, të shpërndara në kohë reale në memorie, në të gjithë komponentët e grupimit.
  - ii. Të mundësojë vendosjen e mbledhësit në Cluster në çdo pajisje virtuale të tij dhe korrelimi të funksionojë pa konfigurim nga përdoruesit.

- 
- iii. Të sigurojë raportime të kategorizuara dhe raporte analitike në të gjithë grupin SIEM. Kjo duhet të jetë e automatizuar dhe përdoruesi nuk duhet të ketë nevojë të specifikojë se cili komponent duhet të ekzekutojë një kërkim. Përkundrazi, duhet të menaxhohet në mënyrë dinamike.
  - d. Grupi SIEM nuk duhet të kufizojë sasinë e të dhënave të ngjarjeve të ruajtura. Ky kufi duhet të jetë vetëm në kapacitetin e ruajtjes së ofruar. Liçensimi nuk duhet të bazohet në hapësirën ruajtëse si GB në ditë/javë/muaj.
  - e. Grupi SIEM duhet të jetë në gjendje të shkallëzohet. Kështu, grupi SIEM mund të fillojë me një pajisje virtuale të vetme dhe të rritet duke shtuar më shumë pajisje virtuale të tjera. Të dhënat e ngjarjeve mund të ruhen në një disk virtual, kur punohet me një pajisje virtuale të vetme dhe gjithashtu në NFS (network file share) ose ElasticSearch. Kur punohet me SIEM Cluster (disa pajisje virtuale) ngjarjet mund të ruhen në Amazon AWS NFS, ElasticSearch, etj.
  - f. Pajisjet virtuale që shtohen duhet të kenë aftësinë për t'u konfiguruar ose për të përpunuar ngjarje dhe për të ekzekutuar kërkime, ose të dedikuara për kërkime.
  - g. Grupi SIEM duhet të jetë në gjendje të shkallëzohet në më shumë se 500.000 EPS.
  - h. Grupi SIEM duhet të jetë në gjendje të ruajë si regjistrin e ngjarjeve të papërpunuara ashtu edhe regjistrin e ngjarjeve të analizuar e normalizuara në të njëjtën bazë të dhënash.
  - i. Nuk duhet të ketë kërkesë për një nivel regjistrimi të veçantë për të filtruar ose dërguar një nëngrup ngjarjesh nga Mbledhësit në një nivel të caktuar korrelimi. Grupi SIEM duhet të jetë në gjendje të përpunojë çdo ngjarje të përcjellë nga niveli i grumbullimit.
  - j. Të dhënat e ngjarjes duhet të ruhen në një modalitet të ngjeshur.
  - k. Grupi SIEM nuk duhet të përdorë një bazë të dhënash relacionale (MS SQL, PostgreSQL, MySQL, Oracle) për të ruajtur të dhënat e ngjarjes. Një bazë të dhënash moderne duhet të përdoret për të ruajtur të dhënat e ngjarjeve, të tilla si: bazë të dhënash NoSQL ose ElasticSearch.
  - l. Duhet të ofrojë mundësinë për të përdorur një bazë të dhënash të ngjarjeve ElasticSearch (ES) të ofruar nga klienti. Klienti mund të ekzekutojë veglat Elastic në bazën e të dhënave ElasticSearch.
  - m. Kur përdoret ElasticSearch, SIEM duhet të sigurojë dhe menaxhojë nivelet e 'HOT' dhe 'Warm Storage' me ES.
  - n. Në rastet kur përdoret ES, nuk duhet të ketë ndryshime të dukshme në GUI krahasuar me rastet kur përdoret SIEM me bazën e të dhënave NoSQL të integruar.
  - o. Një bazë të dhënash relacionale mund të përdoret për të ruajtur template, incidente dhe informacione të tjera të strukturuar.
  - p. Pajisja virtuale duhet të funksionojë në Linux dhe të ketë aftësinë për të përditësuar paketat e OS.

- 
3. SIEM duhet të jetë në gjendje të mbledhë ngjarje me kontekst shtesë përtej të dhënave të regjistrave nga pajisjet dhe kjo duhet të arrihet me:
- a. Zbulim aktiv i pajisjeve brenda rrjetit pa një agjent dhe përdorimi i protokolleve standarde, si:
    - i. SNMP
    - ii. WMI
    - iii. VM SDK
    - iv. OPSEC
    - v. JDBC
    - vi. Telnet
    - vii. SSH
    - viii. JMX
  - b. Të ketë aftësi për të monitoruar statusin dhe reagimin e shërbimeve duke përfshirë DNS, FTP/SCP, TCP/UDP gjenerike, ICMP, JDBC, LDAP, SMTP, IMAP4, POP3, POP3S, SMTP, SSH dhe Web — HTTP, HTTPS (me një dhe shumë hapa). Rezultatet e këtij monitori të disponueshmërisë mund të përdoren për të llogaritur aftësinë e shërbimit, si p.sh. disponueshmëria e një shërbimi është 99%.
  - c. Pasi të zbulohet pajisja, duhet të paraqitet në një bazë të dhënash të menaxhimit të konfigurimeve (CMDB), të ndërtuar brenda zgjidhjes SIEM, jo si një modul i veçantë.
  - d. Pajisjet e zbuluara duhet të caktohen në mënyrë dinamike në Grupet CMDB bazuar në vetitë e personalizuara të përcaktuara nga klienti
  - e. CMDB duhet të ruajë:
    - i. Versioni/Firmware/OS i instaluar në pajisje
    - ii. Numri serial i pajisjes
    - iii. Ndërfaqet e konfiguruar në pajisje së bashku me:
      - 1) Emri i ndërfaqes
      - 2) IP dhe nënrrjet (subnet)
      - 3) Statusi i ndërfaqes (i aktivizuar, i çaktivizuar)
      - 4) Çdo nivel sigurie i konfiguruar në pajisje
      - 5) Shpejtësia e ndërfaqes
      - 6) Shpejtësia dhe emri i ndërfaqes duhet të jenë të redaktueshme
    - iv. Vlerat e personalizuara sipas nevojës.
    - v. Proceset që ekzekutohen në pajisje ose në sistemin operativ
    - vi. Paralajmërim kur ka një ndryshim të statusit të procesit, duke monitoruar në mënyrë aktive duke përdorur protokollin, siç përshkruhet në paragrafin 3.a. Për shembull, alarmi kur një proces ose shërbim ndalon.
  - f. Pajisjet duhet të popullohen automatikisht brenda Grupeve në CMDB, si rezultat i procesit të zbulimit për shembull: Grupi i Serverave të Windows/Linux, Grupi i Firewall-eve, etj.
  - g. Aplikacionet që ekzekutohen në pajisje duhet të zbulohen automatikisht, ndërkohë CMDB duhet të ketë një grup aplikacioni i cili plotëson automatikisht pajisjet nën grup. Për shembull, grupi i aplikacioneve "Serverët IIS" duhet të listojë të gjitha pajisjet që përdorin Microsoft IIS e kështu me radhë.
  - h. Importimi i informacion në CMDB të mund të kryhet nëpërmjet CSV.

- 
- i. Të ketë mundësi publikimi të informacionit të CMDB në sisteme të jashtme si ServiceNow, ConnectWise, etj.
  - j. Të jetë në gjendje të raportojë për të gjitha informacionet e CMDB:
    - i. Raportim mbi firmuerin e pajisjeve ose versionin
    - ii. Të paraqesë raportin e auditimit me kalim/dështim nëse pajisja ka versionin e duhur të Versionit/Firmware/OS të instaluar në të.
  - k. Pasi zbulimi aktiv i pajisjeve të përfundojë, SIEM duhet të ketë një model të integruar që do të përcaktojë automatikisht se cilat parametra/vlera do të mblidhen për pajisjet, si dhe intervalet e grumbullimit. Parametrat/vlerat duhet të mblidhen duke përdorur protokollet e përmendura në paragrafin 3.a.
  - l. Metrikat e performancës të grumbulluara, të cilat nuk bazohen në log-et e gjeneruara nga pajisja, duhet të përfshijnë:
    - i. Përdorimi i ndërfaqes, gabimet, bajtet e dërguara dhe të marra
    - ii. CPU
    - iii. Memorja
    - iv. Disku
    - v. Shfrytëzimi i procesit
4. SIEM duhet të sigurojë një ndërfaqe të unifikuar analitike që lejon përdorimin e të njëjtës gjuhë të kërkesave, për të analizuar të dhënat e log-eve dhe të performancës.
  5. Sistemi i analizimit duhet të suportojë kërkesat e ndërlidhura, ku një përdorues mund të përdorë një kërkesë për të filtruar rezultatet e kërkesës së mëparshme.
  6. Sistemi duhet të jetë në gjendje të neglizhojë ngjarje në mbledhës, të cilat nuk janë të përshtatshme ose nuk nevojiten. Kjo nuk duhet të ndikojë në liqensimin e sistemit.
  7. Si të dhënat e papërpunuara, ashtu edhe ato të analizuar duhet të kalojnë në SIEM nga Mbledhësit. Nuk duhet të përdoret bazë e veçantë të dhënash për të dhëna të papërpunuara dhe/ose të analizuar.
  8. Përpunimi i të dhënave të ngjarjes duhet të kryhet nga analizuesit në momentin e marrjes së ngjarjes.
  9. Të gjithë analizuesit duhet të jenë në gjendje të modifikohen dhe personalizohen.
  10. Analizuesit e personalizuar duhet të jenë në gjendje të krijohen dhe përcaktohen në GUI pa nevojën e aksesit në CLI.
  11. Atributet e reja (variablat e analizuar), pajisjet dhe llojet e ngjarjeve mund të shtohen nëpërmjet GUI-së pa nevojën e aksesit në CLI.
  12. Analizuesit duhet të përcaktohen me anë të një metodologjie XML me aftësitë e mëposhtme:
    - a. Aftësia për të përcaktuar modele që përsëriten si variabla.
    - b. Aftësia për të përcaktuar funksionet për të identifikuar çiftet e vlerave kyçe.
    - c. Aftësia për të përcaktuar funksionet për të analizuar ngjarjet e strukturuar JSON.
    - d. Aftësia për të kryer funksione testimi brenda analizuesit.
    - e. Aftësia për të kryer transformime të të dhënave në fazën e analizimit.
  13. Të ketë mundësi të monitorojë pajisjet pa agjentë nëpërmjet SSH, telnet WMI, JMX dhe PowerShell.
  14. Të ketë aftësi për të mbledhur ngjarje të Windows nëpërmjet WMI dhe agjentëve.
  15. SIEM duhet të sigurojë një agjent Windows, i cili ka aftësitë e mëposhtme:
    - a. Agjentë të menaxhuar në mënyrë të centralizuar nëpërmjet pajisjes SIEM. Nuk duhet të përdoret asnjë pajisje ose konsolë menaxhimi e veçantë.
    - b. Të mund të mbledhë log-e nga skedarët tekst në pajisjet Windows.

- 
- c. Të mund të mbledhë edhe ngjarje të ndryshme përveç atyre të Sigurisë, Sistemit dhe Aplikacionit.
  - d. Të mundësojë monitorimin e integritetit të skedarit.
  - e. Të kryejë monitorimin e Regjistrimit.
  - f. Të mundësojë monitorimin e pajisjeve të lëvizshme.
  - g. Të ekzekutojë komandat e PowerShell dhe të dërgojë rezultatet përsëri si log-e.
  - h. Të ekzekutojë komandat WMI dhe të dërgojë rezultatet përsëri si log-e.
  - i. Agjenti i Windows duhet t'i dërgojë të dhënat e ngjarjeve përsëri te komponentët SIEM në formë të koduar duke përdorur HTTPS.
  - j. Të zbulojë ndryshimet e të drejtave dhe pronësisë së skedarit.
  - k. Të ketë aftësi për të push-ur skedarët e monitoruar nga agjentët në pajisjet virtuale, ku një gjurmë auditimi e ndryshimeve të skedarëve mbahet në bazën e të dhënave. Përdoruesi mund të ekzaminojë më pas ndryshimet midis versioneve të skedarëve të ndryshuar.
  - l. Të ketë aftësi për të zbuluar ndryshimet e skedarëve.
16. SIEM duhet të sigurojë akses të bazuar në role për të kufizuar aksesin në të dhëna dhe gjithashtu të kufizojë aksesin në GUI.
  17. SIEM duhet të jetë në gjendje të zbulojë Active Directory dhe LDAP dhe të shfaqë direktorinë në GUI.
  18. Direktoria mund të përdoret për filtrime brenda raporteve dhe analizave.
  19. Metodatat e autentikimit nga jashtë duhet të suportojnë dhe përfshijnë:
    - a. Active Directory
    - b. LDAP
    - c. RADIUS
  20. Aftësia për të integruar burimet e Threat Intelligence - TI:
    - a. Integrimi i skedarëve CSV mund të kryhet nëpërmjet GUI
    - b. Integrimi nëpërmjet REST API me formate të ndryshme të dhënash (CSV, Custom, STIX)
    - c. Suport për STIX/TAXII
    - d. Suport për
      - i. Adresat IP
      - ii. Domain-et
      - iii. Hash-e
      - iv. URL-të
      - v. Emrat e proceseve keqdashëse (malware)
    - e. Çdo TI të ketë mundësi të suportojë deri në 200.000 hyrje.
    - f. Të mundësojë integrimin me një numër të caktuar të TI komerciale dhe Open-Source.
    - g. Të ketë aftësi për të korreluar të dhënat TI në kohë reale me të dhënat e ngjarjeve në memorie.
    - h. Të ketë aftësi për të korreluar të dhënat e TI me të dhënat e ngjarjeve historike.
  21. Të ketë aftësi për të kërkuar ngjarje dhe t'i analizojë gjatë transmetimit, në kohë reale, në mënyrë që të raportohet për ngjarjet përpara se të ruhen në disk.
  22. Të sigurojë raporte "out-of-the-box", pa pagesë/liçensë shtesë, për:
    - a. PCI-DSS
    - b. HIPAA
    - c. SOX
    - d. NERC

- 
- e. FISMA
  - f. ISO
  - g. GLBA
  - h. GPG13
  - i. Kontrollat kritike SANS
23. Të ketë aftësi për të eksportuar dhe importuar panele/konsola, raporte dhe rregulla nëpërmjet XML.
24. Të ketë aftësi për të mbledhur konfigurimin e pajisjes së rrjetit, për të identifikuar ndryshimet dhe për të ofruar krahasime.
25. Paneli të sigurojë një paraqitje me ngjyrat: të gjelbër, portokalli dhe të kuq të statusit të regjistrimit të pajisjeve të monitoruara.
26. Paneli i kontrollit të ketë mundësinë të paraqitet nëpërmjet slide-ve.
27. Paneli i kontrollit duhet të suportojë paraqitjen e llojeve të mëposhtme të grafikëve:
- a. Bar
  - b. Pie
  - c. Line
  - d. Choropleth
  - e. Chord view
  - f. Clustered Bubble Chart
  - g. Column Trend
  - h. Heat Map
  - i. Pivot Table View
  - j. Sankey Diagram
  - k. Sunburst Chart
  - l. Table
  - m. Combination (line and table view)
  - n. Tree map
  - o. Scatter graph
  - p. Single values
  - q. Gauges
  - r. Geographical Map
  - s. Red, Orange, Green - vlerat mund të përcaktohen në grafikët kur është e përshtatshme.
28. Njoftimi dhe Menaxhimi i Incidentit
- a. Të mundësojë metodologji të njoftimit të incidentit bazuar në politika.
  - b. Të ketë aftësi për të aktivizuar një skript korrigjues kur ndodh një incident i caktuar.
  - c. Të mundësojë integrim të bazuar në API me sistemet e biletave të jashtme si ServiceNow, ConnectWisem Remedy, etj.
  - d. Të ketë aftësi për të zgjeruar integrimin e sistemit të biletave nëpërmjet API me sistemet e palëve të treta.
  - e. Sistemi i integruar i menaxhimit të biletave/rasteve
    - i. Të ketë aftësi për të përcaktuar një politikë përshkallëzimi, e cila të dërgojë një email tek menaxhmenti kur të arrihet një prag i caktuar.
    - ii. Të ketë aftësi për të shtuar në bileta dokumenta të tipeve PDF, PNG, etj.
    - iii. Të ketë aftësi për t'i caktuar bileta operatorëve të tjerë.

- iv. Të mundësojë monitorim të shtrirë në kohë për të kapur aktivitetet e një ngjarje dhe të incidenteve të lidhura.
- v. Të mundësojë metrikën mesatare të kohës deri në zgjidhje.
- f. Të mundësojë procese riparimi të ekzekutueshme në mënyrë automatike dhe manuale në pajisje ose aplikacione të ndryshme.
  - i. Zgjidhja duhet të ketë të paktën 25 skripte të integruara të riparimit për prodhues të ndryshëm si, por pa u kufizuar në: Microsoft, Linux, Palo Alto, Infoblox, Cisco, Aruba, Fortinet, etj.
  - ii. Skriptet e riparimit mund të shkruhen në gjuhë të ndryshme duke përfshirë Python, Bash, Perl, etj.

#### 29. Analizë e fuqishme dhe e shkallëzuar

- a. Të kërkojë ngjarje në kohë reale - pa pasur nevojë për indeksimin dhe përdorimin e parametrave logjikë si AND, OR, NOT dhe ().
- b. Të mundësojë kërkime të bazuara në fjalë kyçe dhe kërkime sipas attributeve të ngjarjeve të analizuara.
- c. Të mundësojë kërkim të ngjarjeve historike të ngjashme me kërkesa SQL (queries) me kushte filtrimi Boolean, grupim sipas agregimeve përkatëse, filtra për kohën, përpuethshmëri të shprehjeve të rregullta, shprehje të llogaritura - GUI dhe API.
- d. Parametrat për kërkim duhet të përfshijnë =, !=, <, >, IS NULL, IS NOT NULL, përmban, nuk përmban, përmban regex, nuk përmban regex, etj.
- e. Të mundësojë modele komplekse të ngjarjeve në kohë reale duke përdorur mekanizmin e rregullave.
  - i. Rregullat duhet të jenë në gjendje të ndryshojnë nga pragjet e thjeshta si p.sh. numri X i ngjarjeve me Y - Sasinë e kohës nga Z - Vlerat e dallueshme.
  - ii. Modele gjithëpërfshirëse që mbështesin logjikën e plotë Boolean dhe që lejojnë:
    - 1) Nën-modele të lidhura në dimensionin kohor nga parametra të tillë si AND, OR, FOLLOWED BY, AND NOT, dhe NOT FOLLOWED\_BY
    - 2) Çdo nën-model mund të filtrojë dhe të aplikojë parametra agregimi si AVG, MAX, MIN, COUNT dhe COUNT DISTINCT
    - 3) Pragjet mund të jenë statike ose të nxjerra nga të dhënat në mënyrë statistikore.
      - a) Profilizimi statistikor dhe njoftimi i ngjarjeve duhet të përfshijë:
        - i. Lëvizjet mesatare
        - ii. Devijimet standarde
      - b) Nëse një prag statistikor tejkalohet, atëherë duhet të krijohet një sinjalizim pothuajse në kohë reale.
- f. Të përdorë objektet e zbuluara CMDB dhe të dhënat e përdoruesit/identitetit dhe vendndodhjes në kërkime dhe rregulla.
- g. Të planifikojë dhe gjenerojë raportet, si dhe të dërgojë rezultatet me anë të email.
  - i. Të ketë aftësi për të eksportuar raporte në CSV dhe PDF.
- h. Të kërkojë ngjarje në të gjithë organizatën, ose deri në një domain raportimi fizik ose logjik.
- i. Të mundësojë lista dinamike të monitorimit, për të ruajtur gjurmët e shkelësve kritikë, me aftësinë për të përdorur listat e monitorimit në çdo raport ose rregull.
- j. Të mundësojë shkallëzimin e analizuesve duke shtuar nyje të pajisjeve virtuale pa ndërprerje në grupin SIEM.



- 
- k. Të mundësojë prioritizimin e raportit të incidenteve nëpërmjet kriticitetit të shërbimeve të Biznesit.
  - l. Emrat e incidenteve duhet të suportojnë vlera dinamike si p.sh. : Identifikimi i dështuar nga [përdoruesi1]. ‘Përdoruesi 1’ është vlera dinamike.
  - m. Rregullat e korrelimit të mund të përcaktohen në kategoritë MITTRE. (<https://attack.mitre.org/matrices/enterprise/>) dhe pamja e incidenteve duhet të përfshijë pajisjet e hartës së panelit/konsolës, incidentet dhe kategorinë e tyre MITTRE.
  - n. Zgjidhja duhet të ketë një aftësi të integruar të zbulimit të ngjarjeve ‘false positive’, si p.sh. të jetë në gjendje të kërkojë ID-në e CVE nga ID-ja e nënshkrimit të IPS nëpërmjet API. Më pas, bazuar në dobësitë e saj, të përcaktojë nëse një pajisje është e cënueshme ndaj sulmit ose jo.
  - o. Të jetë në gjendje të lidhë automatikisht përdoruesin me vendndodhjen dhe adresën IP:
    - i. Të sigurojë mundësinë për të raportuar dhe kërkuar nga përdoruesi në adresën IP në vendndodhje. Vendndodhja mund të jetë porta fizike në switch, adresa mac ose VPN.
    - ii. Të pasurojë ngjarjet ku nuk ofrohet asnjë kontekst përdoruesi, bazuar në adresën IP.
  - p. Nëse ndodh një incident, të jetë në gjendje të kryejë një përgjigje të automatizuar.
30. Të ketë aftësi për të përcjellë çdo informacion të mbledhur të ngjarjes nëpërmjet metodologjisë Kafka.
  31. Të ketë aftësi për të marrë ngjarje nëpërmjet metodologjisë Kafka.
  32. Të mundësojë arkivim bazuar në politika të të dhënave në një vendndodhje tjetër, si p.sh. një NFS. Të dhënat duhet të jenë në gjendje të bëhen restore nëpërmjet GUI-së për kërkimet analitike.
  33. Të mundësojë verifikimin e integritetit të të dhënave të ngjarjes nëpërmjet GUI, duke rillogaritur hash-in e të dhënave të ngjarjes kundrejt një hash-i të ruajtur brenda SIEM në momentin e shkrimit të ngjarjeve në disk.
  34. SIEM duhet të jetë në gjendje të pranojë një gamë të gjerë informacioni, duke përfshirë të dhëna të strukturuar (të tilla si të dhënat e regjistrave dhe ngjarjeve), si dhe të dhëna të pastrukturuar nga burime të shumta, që mund të përdoren për të analizuar dhe monitoruar sistemet.
  35. SIEM duhet të jetë në gjendje të klasifikojë qartë llojet e ndryshme të të dhënave që mbledh për të ndihmuar në përdorimin e tyre gjatë analizës. Ai gjithashtu duhet të jetë në gjendje të klasifikojë të dhëna të tilla bazuar në ndjeshmërinë e tyre ose mbrojtjen e kërkuar të sigurisë/privatësisë, atje ku është e përshtatshme.
  36. SIEM duhet të ketë aftësinë për të ruajtur bazat e veta të njohurive/informacionit. Këto mund të përfshijnë dokumentacione të gjeneruara nga proceset, dokumentacione të produkteve të ndryshme, procedurat, skriptet dhe pjesë nga kode të zhvilluara IT e klientit. Mund të përfshijë gjithashtu informacione të lidhura me klientët, duke përfshirë kontaktet e tyre, lidhjet me CRM dhe forma të tjera të ngjashme të informacioneve. Ai gjithashtu duhet të ofrojë aftësinë për t'u integruar me platformat ekzistuese, p.sh. të tipit Wiki.
  37. Sistemi duhet të jetë i licencuar :
    - a. të grumbullojë ngjarje/log-e nga të paktën 200 pajisje;
    - b. të mundësojë instalimin e të paktën 200 agjentëve nëpër pajisje;
  38. Garancia dhe suporti i sistemit të jetë 1 vit.

## UEBA (User and Entity Behavior Analytics)

1. Duhet të ketë një zgjidhje të integruar UEBA që ofron:
  - a. Vizibilitet të aktivitetit të përdoruesve në pikat fundore, si në rrjet ashtu edhe jashtë saj.
  - b. Vizibilitet të përdorimit të mediave të lëvizshme (disqet e jashtëm, media USB, etj.).
  - c. Zbulim të anomalive të sjelljes së përdoruesit bazuar në AI (Artificial Intelligence).
  - d. Zbulim të anomalive të përdoruesit bazuar në rregulla.
  - e. Aftësi për të kërkuar loget e pikave fundore si pjesë e një ndërfaqe të unifikuar analitike që mbulon loget e pikës fundore, pajisjes së rrjetit, serverit dhe performancës.
  - f. Arkitekturë e shkallëzueshme që mund të suportojë shumë pika fundore.

## MITRE ATT&CK

1. Duhet të ofrojë aftësi të MITRE ATT&CK, duke përfshirë:
  - a. Të paktën 900 rregulla të përputhen me taktikat dhe teknikat e MITRE ATT&CK.
  - b. Të ketë aftësi për të lidhur rregullat e sistemit dhe ato të personalizuar me teknikat ATT&CK.
  - c. Të ketë aftësi për të lidhur teknika të shumta ATT&CK me një rregull (grupim 'many-to-one').
  - d. Një konsolë që shfaq në detaje mbulimin aktual të rregullave MITRE ATT&CK.
  - e. Vizualizim të sulmit të përqëndruar në host.
  - f. Aftësi për të kërkuar incidente të shkaktuara nga teknika ATT&CK.
  - g. Integrim me bazën e të dhënave MITER ATT&CK për të lejuar analistët të aksesojnë shpejt informacionin përkatës.

## Detaje teknike per infrastrukturen dhe konfigurimin

### Mënyra e implementimit

Për konfigurimin e SIEM sugjerohet të shkojet me një nga skenarët mëposhtë:



## Arkitektura dhe performanca

Mëposhtë janë disa detaje për infrastrukturën e nevojshme për implementimin e sistemit SIEM:

Për një konfigurim me 200 Devices, 10,000 EPS (evente për sekondë), 60 rregulla komplekse në kohë reale (complex Realtime rules), 90 raporte të personalizuara (custom reports):

- Realtime queries may span up to the previous 24 hours and must complete in <5min
- Reports can be scheduled during off peak times, but must complete in <10min
- 30 days hot, 90 days warm, 275 days cold

## Infrastrukturës duhet te jete

- 1 Supervisor (Processors 8 core, Memory 24 GB)
- 4 Workers (Processors 8 core, Memory 16 GB)
- 1 NFS Server (Processors 4 core, Memory 16 GB)
- Online Storage for 90 days: 10 TB
  - Online Storage must have at least 200 IOPS
- NFS Storage on separate 1Gbps Ethernet (Assume full analytics on 10K EPS)

## Pajisjet, zërat dhe sasitë

Nr.	Lloji i Produktit	Sasia
1	NG Firewall (OST Qendër)	2
2	NG Firewall (OST Fier / DR Site)	2
3	NG Firewall (çdo pikë fundore / degë)	20
4	Management SW solution for network and security policies	1
5	Security Analytics & Automation	1
6	Sistemi SIEM	1
7	Implementimi	1

## Implementimi

Faza e implementimit të këtij sistemi mendohet të jetë:

Përshkrimi	Kohëzgjatja
Lëvrimi i pajisjeve në OST	60 ditë
Plani i detajuar (sëbashku me IT e OST)	10 ditë
Instalimi fizik nëpër site dhe konfigurimi fillestar i pajisjeve	30 ditë
Konfigurimi i rregullave të komunikimit, krijimi i VPN dhe konfigurimi i SIEM	20 ditë
Testimi dhe trainimi	15 ditë

## Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

### FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet: Sipas Specifikimeve Teknike (Shtojca 5) dhe Listes së Cmimeve (Shtojca 2)

Afatet e lëvrimit: **6 (gjashte)** muaj nga hyrja ne fuqi e kontrates

Artikulli	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
1	“Platforma për menaxhimin e sigurisë së informacionit dhe eventeve dhe mbrojtja perimetrale”	1	OST sh.a.	<b>6 (gjashte)</b> muaj nga hyrja ne fuqi e kontrates, sipas pershkrimit te bere ne Specifikimet Teknike Shtojca 5

## Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, oseqë ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

---

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

*Sipas pikes 1 te kesaj shtojce.*

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

- 2.2.1 *Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë xhiro minimale vjetore të realizuar, për periudhën e 3 (tre) viteve të fundit financiare, te paktën 30,000,000 (tridhjetë milion) Leke.*

*Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.*

*Si prove per plotesimin e ketij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje vertetim nga Administrata Tatimore ku te tregohet xhiroja vjetore per vitet e siperpermendura dhe kopje të certifikuara të bilanceve ku të paktën në dy bilance, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

#### **2.3 Kapaciteti teknik:**

- 2.3.1 *Operatori ekonomik ofertues duhet te kete realizuar gjate tri viteve te fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, kontrata te ngjashme ne nje vlere te pakten prej 13,000,000 (njemdhjetë milion) Lekë pa TVSH.*

*Lidhur me kete pike:*

*Kur OE ka realizuar kontrata me nje ent publik, kerkohen vërtetime të lëshuara nga ky i fundit, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të*

---

deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar për mallrat dhe shërbimet objekt prokurimi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun e prodhuesit për të gjitha mallrat objekt prokurimi.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij, prej një periudhe prej 6 muaj nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, punonjësit e nevojshëm të certifikuar nga prodhuesi i zgjidhjes që do të ofrohet nga OE, si vijon:

✓ Te pakten 1(një) punonjës të certifikuar në PMP/Prince 2 ose ekuivalent në nivelin profesional për menaxhimin e projekteve.

✓ Te pakten 2(dy) punonjës të certifikuar nga prodhuesi i platformes për sigurinë e rrjetit informatik nga të cilët të pakten 1(një) prej tyre të jetë në nivelin profesional.

Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë certifikatat përkatëse të vlefshme të punonjësve, CV dhe kontratat e punës të vlefshme.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatit të ankimimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues që do të realizojë këtë kontratë, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat përkatëse të vlefshme të ISO, të leshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, që kanë lidhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

➤ ISO 9001: për Sistemin e menaxhimit të cilësisë.

➤ ISO 22301: për vazhdimësinë e biznesit.

➤ ISO 27001: për Menaxhimin e sigurisë së informacionit.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë që mallrat e furnizuara janë të reja (jo të rikonstruara).

2.3.7 Në funksion të plotësimit të Shtojcës 8 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet të japë të dhëna të qarta si Emer, Mbiemër, Atesë, Amesi, Datelindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje të skanuar të dokumentit të identifikimit (shqiptar

---

*ose te huaj), per Administratorin/Administratoret e shoqerise, Ortakun/Ortaket e shoqerise, perfaqesues te ndryshem te posacem te shoqerise, drejtues te ndryshem te shoqerise.*

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Shenim:** Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.



## Shtojca 8

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

#### A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

#### B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: <ul style="list-style-type: none"><li>• <b>Informacione për nënkontraktorin</b></li></ul>
---

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

## Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

### A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët

